

AKT - THEMELIMI I SHOQËRISË TREGTARE “NOBUS Construction” sh.p.k

Sot, më datë 10.03.2025 (dymijë e njëzet e pese) une themeluese e shoqërisë:

Marsida Tabaku, e bija e Rauf dhe Manushaqe, lindur në datë 03/04/1990 në Berat, pajisur me Dokument Identifikimi me Nr. J05403063U, madhor me zotësi të plotë për të vepruar.

Në bazë të vullnetit tonë të lirë dhe të pakushtëzuar, në mbështetje të Ligjit Nr.9901 dt.14/04/2008, “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare”, kemi vendosur të themelojmë Shoqërinë Tregtare “NOBUS Constructon” sh.p.k, sipas percaktimeve të bërë në Akt-Themelimi dhe Statut.

Neni 1- FORMIMI

Formohet Shoqëria Tregtare me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin “NOBUS Construction” sh.p.k me nje ortakë themeluese, Znj. Marsida Tabaku.

Neni 2 - SELIA

Shoqëria Tregtare “NOBUS Construction” sh.p.k e ka selinë ligjore në Tirane : Rruga Sulejman Delvina, Pallati Melrose, Ap.15, Tirane, me të drejtë për të ndryshuar qendrën e saj si dhe për të hapur degë dhe filiale të tjera në të gjithë Republikën e Shqipërisë si dhe jashtë saj në përputhje me Legjislacionin Shqiptar


Neni 3 - KOHËZGJATJA

Shoqëria Tregtare “NOBUS Construction” sh.p.k ka një kohëzgjatje të veprimtarisë së saj ekonomike të pakufizuar.

Neni 4 - OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Objekti i veprimtarisë ekonomike i Shoqërisë Tregtare “NOBUS Construction” sh.p.k është përcaktuar me hollësi në nenin 2 të Statutit të kësaj shoqërie. Kështu konkretisht kjo shoqëri do të ushtrojë aktivitetin e saj në fushën:

Projekte dhe studime ne fushen e urbanistikes dhe te ndertimit. Asistence, mbikeqyrje dhe ekspertize teknike ne fushen e ndertimit. Shfrytezim, perpunim e tregtim per materiale inerte, druri e cdo element tjeter ndertimi, prodhim e tregtim materialesh ndertimi. Ndertime dhe rikonstruksione te objekteve me karakter civil, industrial, turistik, shendetesor, shoqeror, kulturor, tregtar, bujqesor, infrastrukture, punime dheu, vepra kullimi, ujesjellesa e kanalizime, sistemime, tarracime terrenesh, punime ne rruge dhe asfaltime. Import eksport, tregtim me shumice e pakice per mallra industriale, lende te pare e te perpunuar, materiale ndertimi, makineri e automjete, pjese kembimi per to, sherbim servisi, transport mallrash brenda dhe jashte vendit. Ndertime dhe rikonstruksione private



dhe publike, civile dhe ushtarake, si dhe çdo lloji ndryshimi dhe permiresime ne ndertesat ekzistuese. Kryerja e aktiviteteve ti ndryshme ne fushat e tregtise, prodhimit dhe te sherbimeve te ndryshme. Import-eksporti i materialeve te ndertimit, makinerive e pajisjeve, dhe te çdo malli dhe produkti ne funksion te objektit te veprimtarise se shoqerise. Kooperimi dhe ndermjetesimi ne veprimtari te ndryshme sherbimi, si ne fushen e tranzitit te mallrave dhe te sherbimeve, te magazinimit, te shperndarjes se materialeve etj. Shitblerja e pasurive te paluajtshme drejperdrejt apo nepermjet hapjes se angjensive imobilare. Investime ne fushen e turizmit, hotelerise, hapjen dhe zhvillimin e aktivitetit te agjensive turistike.

Neni 5 - KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i Shoqërisë Tregtare **"NOBUS Construction" sh.p.k** është 100 (njëqind) lekë, i cili është nënshkruar dhe shlyer totalisht si kapital në para. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre te mëposhtme:

1. Ortaku themelues Znj. Marsida Tabaku: Zoterues i 1 (një) kuote me 100 (njëqind) lekë, që përbën 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Neni 6 – ADMINISTRATORËT

Shoqëria Tregtare **"NOBUS Constructon" sh.p.k** ka si Administratore të saj Znj. Marsida Tabaku e cila ushtron dhe ndjek aktivitetin e shoqërisë duke zbatuar kompetencat përkatëse sipas statutit të shoqërisë.

Afati i emerimit të administratorit Znj. Marsida Tabaku do të jetë për një afat 5 (pesë) vjeçar, duke nisur nga dita e nënshkrimit të këtij Akti.

Neni 7 – VULA E SHOQËRISË

Shoqëria ka vulën e saj zyrtare me përmbajtje:
Shoqëria Tregtare **"NOBUS Construction" sh.p.k**

Neni 8 - BILANCI DHE TË ARDHURAT

Viti financiar i Shoqërisë mbyllet në 31 dhjetor të çdo viti.

Në mbylljen e çdo viti financiar, Administratori i Shoqërisë bën inventarin dhe llogaritë vjetore, në përputhje me dispozitat ligjore mbi kontabilitetin, si dhe harton një raport me shkrim për administrimin.

Raporti i administrimit, inventarët dhe llogaritë vjetore të hartuara nga Administratori, i nënshtrohen miratimit të Ortakeve brenda një afati prej 6 muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar.

Neni 9 - SHPËRBËRJA E SHOQËRISË

Shpërbërja e Shoqërisë Tregtare **“NOBUS Construction” sh.p.k** mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkak, duke vepruar sipas kritereve të parashikuara në Statutin e Shoqërisë.

Neni 10- DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Ky Akt themelues (kontratë) përpilohet në disa kopje për :

- Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, për të bërë veprimet në Rregjistrin Tregtar.
- Një kopje mbahet nga shoqëria si pjesë e dokumentacionit të themelimit të Shoqërisë Tregtare **“NOBUS Construction” sh.p.k**

Ky akt themelimi mbyllet me 10 (dhjetë) nene.

SHOQËRIA ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“NOBUS Construction” sh.p.k

ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË

Znj. Marsida Tabaku

Marsida Tabaku

